



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 20 shtator 2021
Nr. ref.:RK 1843/21

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI46/21

Parashtrues

Gjergjiz Kryeziu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së disa vendimeve të gjykatave të rregullta

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Gjergjiz Kryeziu (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në fshatin Rogovë, komuna e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend tekstualisht disa vendime të gjykatave të rregullta, përkatësisht atë të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 4610/20 të 2 dhjetorit 2020, dhe atë të Gjykatës Themelore në Gjakovë, PPP. nr. 55/2020, të 26 gushtit 2020, megjithatë këto vendime nuk i janë bashkëngjitur kërkesës.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të sipërcekura, me të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 mars 2021, kërkesa u dorëzua (nëpërmjet postës) në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 5 mars 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 11 mars 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe nga i njëjti kërkoi plotësimin e kërkesës me informata të nevojshme dhe bashkëngjitjen e dokumentacionit mbështetës.
8. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
9. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK160/21 për zëvendësimin e gjyqtarëve kryesues në kolegje shqyrtuese, caktoi Kryetaren e zgjedhur të Gjykatës Gresa-Caka Nimani, kryesuese të Kolegjit në të gjitha rastet ku ishte caktuar anëtare e Kolegjit shqyrtues.

10. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
11. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani, me Vendimin K. KSh. 46/21, për zëvendësimin e gjyqtarëve në kolegje shqyrtuese, në vend të ish-kryetares Arta Rama-Hajrizi, anëtarë të Kolegjit e caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi.
12. Më 10 shtator 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës, që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

13. Parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend tekstualisht vendimet e kontestuar të gjykatave të rregullta, me të cilat pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij, megjithatë ato vendime nuk i janë bashkëngjitur kërkesës. Andaj, në këtë kuptim kërkesa nuk përmban fakte dhe dëshmi tjera materiale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi i kërkesës në mënyrë të përgjithshme pretendon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij, pa iu referuar konkretisht ndonjë dispozite kushtetuese.

Pranueshmëria e kërkesës

15. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

17. Gjykata, në rrethanat e këtij rasti specifikisht i referohet nenit 22, paragrafit 4 të Ligjit, që përcakton:

“Nëse kërkesa ... nuk është e ... kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për të ... plotësuar kërkesën (...).”

18. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve], nënregullin (2) shkronja (h) dhe rregullin 35 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës], nënregullin (5) të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

32 (2) “Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

[...]

35 (5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë, përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën, (...).”

19. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij, megjithatë i njëjti nuk i është referuar specifikisht ndonjë neni të Kushtetutës.
20. Në zbatim të dispozitave të lartcekura, Gjykata nuk mund t’i marrë për bazë as faktet e rastit dhe as pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkak se kërkesa është e paplotë, sepse asaj nuk i janë bashkëngjitur vendimet gjyqësore të kontestuarra. (shih, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin KIO3/15, parashtrues *Hasan Beqiri*, të 13 majit 2015, paragrafët 14, 15, 17, 19, 20 dhe 21, si dhe rastin KIO7/16, parashtrues *Rifat Abdullahi*, të 14 korrikut 2016, paragrafi 22).
21. Gjykata, në përmbushje të detyrimeve të saj ligjore më 11 mars 2021, e kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe nga ai kishte kërkuar plotësimin e kërkesës me informata të nevojshme dhe bashkëngjitjen e dokumentacionit mbështetës.
22. Duke iu referuar regjistrin të saj, Gjykata vëren se më 17 mars 2021 parashtruesi i kërkesës e ka pranuar shkresën e Gjykatës, megjithatë kërkesa edhe më tutje mbetet e paplotë, sepse asaj nuk i është bashkëngjitur dokumentacioni mbështetës.
23. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë sa më efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesës së Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, të njëjtat i deklaron si të paqarta dhe të paplota, dhe si rezultat nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesit të kërkesës. (Shih, rastet e Gjykatës, KIO89/18, parashtrues: *Agim Jashari*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 27 nëntorit 2018, paragrafi 29; KIO74/18, parashtrues: *Gëzim Murati*, Vendimi për

refuzimin e kërkesës, i 3 dhjetorit 2018, paragrafi 26; KI78/20, KI79/20 dhe KI80/20, parashtrues: *Hilmi Aliu dhe të tjerët*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 11 nëntorit 2020, paragrafi 33; dhe KI90/20, parashtrues: *Arben Boletini*, Vendim për refuzim të kërkesës, i 25 nëntorit 2020, paragrafi 25).

24. Si përmbledhje, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i përmbush kriteret formale për shqyrtim të mëtejme, për shkak të moskompletimit të saj me dokumentacion mbështetës.
25. Andaj, Gjykata, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit, me rregullin 32 (2) (h) dhe me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, përfundon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 22.4 të Ligjit dhe të rregullave 32 (2) (h) e 35 (5) të Rregullores së punës, më 10 shtator 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën me procedurë të shkurtër;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Remzije Istrefi-Peci

Gresa Caka-Nimani

